

Koha për marrëveshje Negociatat mes Kosovës dhe Serbisë

Udhëheqësit serbë dhe kosovarë u kthyen në tryezën e negociatave në korrik të këtij viti, pas një ndërprerjeje të bisedimeve për dy vjet. Por ‘ardhja në tryezë’ dhe ‘arritja tek një po’ janë dy gjëra të ndryshme. Arritja e dakordimit për një marrëveshje të qëndrueshme dhe të zbatueshme kërkon udhëheqje të përkushtuar nga ana e Kosovës, Serbisë dhe bashkësisë ndërkombëtare. Për politikanët kosovarë dhe serbë, reagimet e mundshme negative të brendshme ndaj ‘pajtitimit për të rënë dakord’ duken një rrezik më i madh sesa zemërimi eventual ndërkombëtar për ‘mosmarrëveshjen.’ Ka mënyra për ta dobësuar këtë hezitim për marrëveshje. Komuniteti ndërkombëtar ka mjaft “shkopinj dhe karrota” për të ndryshuar perceptimin e liderëve për cenueshmërinë e tyre të brendshme. Kjo mund të ndihmojë në lehtësimin e këtyre shqetësimeve duke gjuajtur me karrota të mjaftueshme për të vendosur besimin e publikut në proces. BE-ja ka shumë për t’i ofruar popullatës serbe dhe kosovare, kurse SHBA-të kanë aftësinë e nevojshme për të ndikuar në arrijtjen e një negociate të suksesshme.

Ky raport bazohet në një diskutim të një punëtorie organizuar nga Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse, duke respektuar rregullat e Chatham House, me pjesëmarrjen e një grupi analistësh nga Serbia dhe Kosova gjatë datave 24-26 korrik, 2020 në Kopaonik, Serbi. Diskutimet adresuan dinamikën e re politike, negociatat e rinovuara dhe një rezultat përfundimtar të dialogut. Punëtorja është pjesë e një projekti mbi marrëdhëniet Kosovë-Serbi i mbështetur nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës. Nënkryetari i CIG, Shpetim Gashi përgatiti raportin. Raporti nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e pjesëmarrësve individualë, CIG-së, ose Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.

Ngecje jo e dëmshme

Udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë ndihen të rrezikuar politikisht në vendet e tyre dhe nuk janë nën presionin e mjaftueshëm nga ndërkombëtarët për të arritur një kompromis. Për më tepër, lidërshipi i Kosovës është jo stabil. Presidenti Hashim Thaçi po përballet me një padi të mundshme për krime kundër njerëzimit, ndërsa Kryeministri Avdullah Hoti drejton një koalicion të brishtë dhe është vetë jo aq i dëshiruar nga publiku. Nga ana tjetër, Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vucic, sapo fitoi një mandat dërrmues elektoral por fitorja e tij elektorale nuk duket se përkthehet në një mandat për të bërë “lëshime kushtetuese” në Kosovë.

- Udhëheqja e Kosovës është jo stabile. Rikonfigurimi themelor politik do të ndodhë sapo Gjykata Speciale e Kosovës të konfirmojë paditë e saj kundër udhëheqësve të Kosovës, përfshirë Thaçin. Hoti konsiderohet një kryeministër afatshkurtër dhe si i tillë nuk ka të

ngjarë të përqendrohet në objektiva afatgjatë, siç është arritja e paqes me Serbinë. Humbjet afatshkurtra në negociata zakonisht 'arkëtohen' më vonë. Hoti ka pak nxitje për të ndërmarrë iniciativa të guximshme që sjellin kosto të konsiderueshme afatshkurtra për të dhe përfitime afatgjata që ai vetë nuk ka gjasa të jetë atje për të përfituar nga to. Ndryshe nga Hoti, Vucic është një lider 'afatgjatë'. Dhe kështu është udhëheqësi i opozitës Lëvizja Vetëvendosje (VV) Albin Kurti, i cili mund të jetë më i gatshëm për kompromis pasi ai vetë do të jetë atje për të korrur përfitime në të ardhmen dhe do të kishte kohë të mjaftueshme për t'u rikuperuar nga çdo humbje eventuale afatshkurtra. Një pjesë e rikonfigurimit të skenës politike të Kosovës mund të jetë gjithashtu një zgjedhje e parakohshme parlamentare, por ka shumë gjasa që një riorganizim i qeverisë, ku Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e Kadri Veseli t'i bashkohet koalicionit qeverisës. Polarizimi shoqëror dhe politik është një pengesë kryesore për një kompromis me Serbinë. Gjykata Speciale mund t'i komplikojë gjërat edhe më shumë. Negocimi me Serbinë ndërsa ish-udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë vendosur pas hekurave mund të shihet si tradhëti e atyre që 'çliruan Kosovën'. Si pasojë, qeveria e Hotit do të hezitojë gjithnjë e më shumë për të negociuar me Serbinë dhe partitë politike në Kosovë pritet të rivlerësojnë pozicionet e tyre mbi dialogun pasi të publikohet padia e parë.

- Sondazhet e VV-së së Kurtit janë rreth 50 %, pothuajse aq të larta sa Partia Progresive Serbe (SNS) e Vucic. Një marrëveshje paqeje me Serbinë pa VV-në është e mundur por nuk ka gjasa të bëhet realitet. Në të njëjtën kohë, VV nuk do të mbështesë qeverinë aktuale të Kosovës në asnjë rrethanë. PDK-ja e Veselit dhe AAK-ja e Ramush Haradinajt për nuk janë të etur për të mbrojtur Hotin nga pasojat e një kompromisi dhe nuk mendojnë se një marrëveshje është urgjente. Sidoqoftë, ata do të mbështesin qeverinë në çdo rrethanë për të shmangur një zgjedhje të parakohshme në të cilën do të rezultonin keq. Qeveria Hoti nuk ka gjasa të ketë sukses në zgjidhjen e konfliktit të komplikuar me Serbinë.
- SNS e Serbisë fitoi një shumicë solide në zgjedhjet e fundit, por ky mandat elektoral nuk përkthehet në një mandat për të bërë kompromise të mëdha mbi Kosovën, siç është njohja. Shumica e qytetarëve serbë kundërshtojnë njohjen e Kosovës. Nuk ka mundësi që Presidenti Vucic të rrezikojë mbështetjen e tij të brendshme duke arritur një marrëveshje paqeje me Kosovën. Kundërshtimi i brendshëm i Serbisë është poashtu jo stabil dhe si i tillë nuk ka të ngjarë të kontribuojë në krijimin e kushteve për një përparim politik. Shumica në opozitë janë edhe më pak të përgatitur se SNS për të arritur një marrëveshje paqeje me Kosovën.
- Anëtarësimi në BE mbetet një nxitje dhe katalizator i fortë që mund të inkurajojë Serbinë të shkojë drejt një kompromisi me Kosovën. Megjithatë shumë kanë dilema rreth anëtarësimit në BE, shumica e serbëve vazhdojnë ta mbështesin atë. Për shumë, anëtarësimi në BE në këmbim të heqjes dorë nga Kosova mund të jetë 'një shkëmbim i dhimbshëm, por i pranueshëm.' Por BE-ja nuk duket e gatshme të ofrojë një proces të shpejtë dhe Serbia nuk e konsideron urgjente përmbyshjen e kritereve. Përveç kësaj, BE-ja insiston që Serbia të përmbyshë të gjitha kriteret e tjera dhe veçanërisht ato që lidhen me drejtësinë dhe shtetin e së drejtës. Ashtu si në Kosovë, kushtet në Serbi nuk janë të përshtatshme as për të përparuar.

Kosova dhe Serbia janë në një ngecje jo të dëmshme. Komuniteti ndërkombëtar duket se është gati për një shtytje tjetër, por udhëheqësit në Serbi dhe Kosovë janë të kënaqur me këtë ngecje sepse nuk shkakton dëme. Sidoqoftë, sapo liderët e Kosovës dhe Serbisë të humbin statusin e liderëve të preferuar të BE-së - ka indikacione se BE-ja duket se është ngopur me premtime të pabaza të pafundme - ngecja mund të fillojë të dëmtohet dhe udhëheqësit do të bëhen më të gatshëm të angazhohen në produktivitet dhe negociata me qëllim të mirë. Rritja

e kostos së ngecjes për udhëheqësit është një faktor kryesor për negociata të suksesshme. Komuniteti ndërkombëtar duhet ta bëjë 'mos nënshkrimin' më të kushtueshëm se "nënshkrimin". Thjesht angazhimi në negociata - kryesisht për të mbrojtur veten nga presioni ndërkombëtar dhe për të vazhduar të duken si njerëz të mirë - nuk duhet të jetë më i kënaqshëm për komunitetin ndërkombëtar. Është koha për të treguar rezultate.

Negociatat e rifilluara

Përpyekjet e mëparshme kaotike dhe konfliktoze të bashkësisë ndërkombëtare kanë filluar të formohen gradualisht në një iniciativë diplomatike më të koordinuar për paqen. Përpyekjet e njëanshme të të dërguarit të Presidentit Trump Richard Grenell u pushuan pasi Gjykata Speciale e Kosovës njoftoi se ka ngritur një aktakuzë kundër Presidentit Thaçi. Shpejt pas kësaj, Kancelarja e Gjermanisë Angela Merkel dhe Presidenti i Francës Emmanuel Macron bashkuan një iniciativë të re të BE-së të kryesuar nga Përfaqësuesi i Lartë i BE-së Josep Borrell dhe të menaxhuar nga i dërguari i BE Miroslav Lajcak. SHBA duket se e mbështetin atë dhe bien dakord të lënë BE të rifillojë rolin kryesor. Iniciativa e BE-së ka një qëllim të qartë - normalizimin gjithëpërfshirës midis Kosovës dhe Serbisë - por ende është duke e kuptuar se si të arrihet atje dhe çfarë do të thotë në të vërtetë. Një plan i mirë duhet të ketë qëllime të qarta dhe strategji për t'i arritur ato. Plani i BE-së duket se ka të parën por jo të dytën.

- Të mbështetur diplomatikisht nga Gjermania dhe Franca, Serbia dhe Kosova kanë filluar një proces të ri duke u përqëndruar në objektivat e tyre - jo në ndryshimet - dhe po përpunon të harmonizojnë këto objektiva. Ata kanë një numër objektivash të përbashkëta - anëtarësimi në BE, zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjes, marrëdhënie të mira ekonomike - që janë gjithashtu në përputhje me interesat e tyre vendore.
- Merkel e Gjermanisë dhe Macron i Francës duket se janë zotuar personalisht të mbikëqyrin procesin e negociatave, të cilin duan të përfundojnë me një marrëveshje paqeje që nuk lë paqartësi politike. Ndërmjetësit ndërkombëtarë duhet t'u bëjnë të qartë palëve se mbështetja e tyre nuk është e pacaktuar ose e pakushtëzuar. Ndryshe nga procesi i mëparshëm i Brukselit, fokusi i iniciativës së re është në mosmarrëveshjet politike.
- Kosova duhet të përqendrohet në atë që mund të marrë nga BE-ja - njohja nga pesë shtetet që refuzojnë ta njohin Kosovën (katër prej të cilave janë në të njëjtën kohë katër anëtarët e vetme të NATO-s që nuk e njohin Kosovën si shtet të pavarur), statusi i kandidatit të BE-së – dhe jo të përqendrohet në atë që nuk mund të marrë nga Rusia dhe Kina - anëtarësimi në OKB. Njohja nga Serbia duhet të jetë një përparësi për Kosovën, por jo përparësia e saj kryesore. Kosova duhet të bëjë një riorganizim të prioriteve, duke ngritur njohjen nga pesë vende të BE-së ndërsa të ulë nivelin e vlerës së njohjes nga Serbia. Ajo duhet ta lejojë BE-në të negociojë njohjen me Serbinë. BE ka më shumë mjete për ta nxjerrë një gjë të tillë nga Serbia.
- Komuniteti ndërkombëtar duhet të hartojë një marrëveshje përfundimtare dhe të ketë palët të diskutojnë propozimin me shkrim. Negociatat e zgjatura mund të minojnë vrullin e negociatave dhe besueshmërinë e BE-së si një aktor që është në gjendje të kujdeset për oborrin e vet.
- Roli i SHBA-ve në ndikimin në Kosovë është i pazëvendësueshëm. Ndryshe nga BE-ja që nuk mund të llojë për njohjen e Kosovës drejtpërdrejt për shkak të pesë anëtarëve të saj jo-njohës, SH.B.A. lobon hapur, duke pasur kështu një reputacion më të mirë në Kosovë.

Bashkëpunimi ekzistues SHBA-BE është minimal në këtë proces. Ata kanë nevojë për më shumë koordinim dhe bashkëpunim për të pasur sukses. Rivaliteti SHBA-BE për Kosovën rrit paqëndrueshmërinë duke rrëzuar një qeveri mjaft të fortë dhe efektive atje në mes të një pandemie. Rivaliteti SHBA-BE duhet të shmanget me çdo kusht. SH.B.A. dhe BE - më tepër atëherë Kosova dhe Serbia - duhet të jenë në sediljen e parë makinës dhe të përdorin ndikimin e tyre për të krijuar vrullin dhe kushtet për një marrëveshje.

- Qasja e negociatave të BE-së duket pragmatike dhe funksionale, duke synuar së pari të vendosë disa blloqe ndërtimi, siç është rritja e bashkëpunimit ekonomik dhe zgjidhja e fatit të personave të zhdukur, përpara se të kalojmë në çështje më të ndjeshme. Në fazën tjetër, BE duhet të përdorë "artilërinë e saj të fortë" - Merkel dhe Macron së bashku me Uashingtonin duke i drejtuar palët në një kompromis.

Procesi i ri i negociatave duket se po shkon drejt një forme të 'normalizimit pa njohje', një hap në dukje i domosdoshëm përpara një zgjidhjeje të statusit përfundimtar. Një ndërrim i shpejtë nga ana e serbëve nga qëndrimi i tyre i "Kosova është Serbi" nuk pritet pasi mund të minojë fuqinë e SNS-së. Mund të hapë gjithashtu kutinë e politikës së brendshme serbe të Pandorës. Udhëheqjet serbe dhe kosovare për vite me radhë kanë hedhur propagandë duke theksuar rëndësinë e 'vazhdimin të luftës' dhe pa dashje e kanë futur veten në një pozicion të vështirë negociimi. Tani atyre u duhet kohë për të përgatitur audiencën e tyre për ndërrime eventuale drastike. Një marrëveshje me njohjen ka shumë të ngjarë të përfundohet vetëm kur Serbia do të bëhet anëtare e BE-së. Vendet kryesore anëtare të BE-së duket se janë të vendosura të mos pranojnë anëtarë të rinj me konflikte të mëdha të pazgjidhura. Megjithëse Kosova mund të ngurrojë të angazhohet për 'normalizim pa njohje', njohja eventuale nga anëtarët e BE-së është edhe më e rëndësishme. Pesë mosnjohësit e BE-së kanë treguar se do të konsideronin njohjen nëse arrihet një marrëveshje midis Prishtinës dhe Beogradit.

Rezultati i dëshiruar

Rezultati i dëshiruar i negociatave është arritja e një marrëveshje gjithëpërfshirëse që i vë marrëdhëniet e shoqërisë kosovare dhe serbe në një trajektore pozitive, duke përmbysur përfundimisht trendet negative shekullore. Një lidhje miqësore midis Kosovës dhe Serbisë në të ardhmen e afërt nuk ka të ngjarë, por të fillosh një marrëdhënie të tillë është e mundur.

- Kundërshtarët e një konflikti të rifilluar serbo-shqiptar përbëjnë shumicën si në shoqëritë e Kosovës, ashtu edhe në ato të Serbisë. Presidenti Vucic kohët e fundit vuri në dukje se "vetëm një përqind e serbëve janë të gatshëm të luftojnë për Kaçanikun", një qytet i vogël në jug të Kosovës. Një tregues i suksesit është kur këta kundërshtarë të konfliktit 'shkojnë një hap më tej dhe bëhen promovues të paqes'. Pranimi nga publiku i një marrëveshjeje mund të ketë përfitime të shumëfishta në fusha të tjera.
- Paralelisht me lehtësimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, bashkësia ndërkombëtare duhet të mbështesë në mënyrë më aktive reformat demokratike në Serbi dhe Kosovë. Historia tregon se ndryshimi drejt demokracisë rrit mundësinë e angazhimit më të fortë ndaj zgjidhjeve paqësore, pasi demokracitë ndajnë perceptime të ngjashme për trajtimin e mosmarrëveshjeve, veçanërisht besimin e tyre në kompromis.
- Një marrëveshje e mirë heq të gjitha kufizimet kufitare, duke lejuar njerëzit dhe mallrat të lëvizin lirshëm.

- Një BE e fortë del nga procesi që tregon se mund të merret me sukses dhe në mënyrë të përshtatshme me çështjet në oborrin e vet para se të dëshirojë të bëhet një lojtar global.
- Një marrëdhënie serbo-shqiptare në mënyrë ideale nuk duhet të formësohet vetëm nga udhëheqës politikë, mite dhe histori, por nga bashkëpunimi ekonomik, shkëmbimet akademike dhe kulturore dhe marrëdhëniet shoqërore.

Serbia dhe Kosova mbeten shtete të varfëra ekonomikisht, të polarizuara politikisht dhe shoqërisht konservatore - elemente jo të favorshme për arritjen e paqes me ish-armiq të dhe zhvillimin e demokracisë. Mbështetja politike dhe ekonomike ndërkombëtare pas marrëveshjes është po aq e rëndësishme sa mbështetja e ndërmjetësimit në konflikt. Shanset për paqe nuk janë të mira. Ekziston një ndjenjë e lodhjes me konfliktin, por edhe me dialogun. Shumë pak progres kërkon shumë kohë për të arritur. Qeveritë dhe njerëzit janë të përgatitur keq për tu përballur me sfidat dhe për të akomoduar kompromise. Negociatat dhe marrëveshjet nuk sjellin vetëm përfitime. Ato sjellin gjithashtu kosto politike ose materiale. Kompromiset mund të kushtojnë politikanëve ca fuqi, veçanërisht kur publiku nuk është i gatshëm. Por vetë politikanët janë fajtorë që nuk përgatisin publikun e tyre që të pranojë edhe këto kosto. Komuniteti ndërkombëtar nuk duhet t'i konsiderojë udhëheqësit e tanishëm të Kosovës dhe Serbisë si "garantuesit e vetëm të stabilitetit". Udhëheqësit kosovarë dhe serbë të dy dekadave të fundit kanë qenë "herë zjarrvënës, herë zjarrfikës, por kurrë paqebërës". Është koha që serbët dhe shqiptarët t'i shpëtojnë 'grackës etnike' një herë e përgjithmonë përmes një marrëveshje paqësore gjithëpërfshirëse. Është koha të bien dakord.

Pjesëmarrësit

Sipas renditjes alfabetike në anglisht

Belul Beqaj, Analist

Shpetim Gashi, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Ismet Hajdari, Gazetar

Milivoje Mihajlovic, Gazetar

Petar Miletic, Analist

Igor Novakovic, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse

Zoran Ostojic, Analist

Dejan Radenkovic, Politikan

Jovana Radosavljevic, Analiste

Alex Roinishvili Grigorev, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse (përmes telekonferencës)

Nexhmedin Spahiu, Analist